

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 1643 Prot.

Patos, 19.05.2026

RAPORT VJETOR I KONSOLIDUAR
i Zbatimit të Buxhetit dhe i Performancës
PËR VITIN 2025

*Bazuar në Nenin 50, 51, 53, 54 të Ligjit nr. 68/2017
"Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"
dhe Nenin 55 të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"*



Përmbajtja

Përmbajtja	1
KREU I: VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI BASHKINË PATOS	3
1.1 Profili Territorial dhe Administrativ	3
1.2 Sfidat Kryesore të Zhvillimit	3
1.3 Zëri i Qytetarëve në Hartimin e Buxhetit 2025.....	4
1.4 Baza Ligjore e Raportimit.....	4
1.5 Fjalori i Termave Financiare.....	4
KREU II: QËLLIMI I BUXHETIT DHE REALIZIMI FINANCIAR - VITI 2025	5
2.1 Miratimi dhe Ndryshimet e Buxhetit 2025	5
2.2 Realizimi i Burimeve të Financimit.....	5
2.3 Realizimi i të Ardhurave Vendore - Detajim i Plotë.....	7
2.4 Realizimi i Shpenzimeve Buxhetore.....	8
2.5 Investimet Kapitale 2025 - Tabela e Detajuar.....	10
2.6 Fondet e Kushtëzuara - Realizimi 2025	11
2.7 Treguesit Financiarë Kyç - Viti 2025	12
KREU III - PJESA A: PROGRAMET III.1 – III.5	28
KREU III - PJESA B: PROGRAMET III.6 – III.9.....	28
KREU III - PJESA C: PROGRAMET III.10 – III.17.....	42
KREU IV: PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TE KONSOLIDUARA	67
IV.1 Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar - Formati nr. 1	67
IV.2 Pasqyra e Konsoliduar e Performances Financiare - Formati nr. 2	68
IV.3 Pasqyra e Konsoliduar e Flukseve Monetare - Formati nr. 3.....	69
IV.4 Pasqyra e Ndryshimeve ne Aktivet Neto / Fondet Neto - Formati nr. 4.....	70
KREU V: RAPORTI I AUDITIMIT	72
5.1 Auditimi i Brendshem - Viti 2025	72
5.2 Zbatimi i Rekomandimeve te Vitit 2024.....	72
5.3 Auditimi i Jashtëm - KLSH	72
6. Tabela e Vleresimit te Performances sipas Sektoreve	73
6.1 Gjetjet Kryesore te Vitit 2025.....	73
6.2 Sfidat Strukturore Kryesore	Error! Bookmark not defined.
6.3 Prioritetet dhe Rekomandimet per Vitin 2026	Error! Bookmark not defined.

KREU I: VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI BASHKINË PATOS

1.1 Profili Territorial dhe Administrativ

Bashkia Patos është pjesë e Qarkut Fier dhe ka një sipërfaqe prej 82.5 km², me qendër qytetin e Patosit. Ajo kufizohet në veri dhe lindje nga Bashkia e Roskovecit, në jug me Bashkinë e Mallakastrës dhe në perëndim me Bashkinë e Fierit. Bashkia përbëhet nga dy njësi administrative: Zharrëza dhe Ruzhdia.

Sipas Censurit të vitit 2023, Bashkia Patos regjistron 18,227 banorë me densitet prej 220.7 b/km². Sipas Regjistrimit të Gjendjes Civile në vitin 2017 rezultoi 42,106 banorë. Patosi është një bashki me qytet industrial relativisht të ri, me histori që humbet në thellësinë e shekujve, ku ndërthuren traditat e Krahinave të Myzeqesë dhe Mallakastrës.

Pasuritë natyrore kanë orientuar ekonominë e Bashkisë drejt sektorit primar dhe industrisë së hidrokarbureve, duke krijuar një pol të rëndësishëm në rang kombëtar. Zhvillimi i ardhshëm synon bashkëjetesën e industrisë me bujqësinë, duke strukturuar vendbanimet, rritur cilësinë e jetës dhe shtuar aktivitetet për t'i shërbyer popullsisë të rajonit të Fierit.

Vizioni: Qeverisje vendore e hapur, e drejtë dhe e përgjegjshme ndaj nevojave të komunitetit. Garantimi që të gjithë qytetarët të trajtohen në mënyrë të barabartë, me dinjitet dhe respekt, të lirë nga diskriminimi - si parim bazë për ndryshime pozitive dhe orientim për zhvillimin e ardhshëm.

Tabela 1.1 - Tregues Demografikë dhe Territorial

Tregues	Vlera
Sipërfaqe (km ²)	82.5
Njësi Administrative	2 - Zharrëza dhe Ruzhdia
Banorë sipas Censurit 2023	18,227
Densitet (b/km ²)	220.7
Banorë sipas Gjendjes Civile 2017	42,106
Qytet-qendër	Patos
Qarku	Fier
Kufizim Veri / Lindje	Bashkia Roskovec
Kufizim Jug	Bashkia Mallakastra
Kufizim Perëndim	Bashkia Fier

1.2 Sfidat Kryesore të Zhvillimit

Bashkia Patos, si bashki me karakter industrial dhe bujqësor, përballet me sfida specifike zhvillimi që orientojnë prioritetet buxhetore vjetore:

- Sistemi bujqësor, urban, natyror, ujqor dhe infrastrukturor - nevoja për modernizim dhe investim të vazhdueshëm.
- Zhvillimi ekonomik i sektorit primar (bujqësi, hidrokarburë), dytësor (industri) dhe terciar (shërbime).
- Marketimi i vlerave, traditave dhe produkteve vendore - ndërtim i brand-it lokal.

(iv) Mbështetja e biznesit lokal, rregjistrimi dhe formalizimi i taksapaguesve.

(v) Sigurimi i aksesit në informacion me lehtësi dhe transparencë, nëpërmjet teknologjisë bashkëkohore.

(vi) Ruajtja e mjedisit dhe menaxhimi eficient i mbetjeve urbane - sfidë e rritur me zgjerimin e rrjetit të shërbimeve.

1.3 Zëri i Qytetarëve në Hartimin e Buxhetit 2025

Edhe gjatë vitit 2025, qytetarët u përfshinë aktivisht në procesin e hartimit të buxhetit. Mendimet dhe propozimet qytetare u mblodhën nëpërmjet: kontakteve të drejtpërdrejta; dëgjësave publike në Patos dhe njësitë administrative; komenteve dhe kritikave të adresuara pranë administratës; publikimeve në faqen zyrtare të Bashkisë. U realizuan 20 konsultime publike nga 22 të planifikuara, me 1,200 pjesëmarrës.

1.4 Baza Ligjore e Raportimit

Ky Raport Vjetor i Konsoliduar hartohet dhe publikohet në zbatim të dispozitave të mëposhtme ligjore:

Akti Normativ	Nenet	Detyrimi Ligjor
Ligji nr. 68/2017 - Per Financat e VQV	50, 51, 53, 54	Hartim dhe dorëzim i raportit vjetor konsoliduar të zbatimit të buxhetit
Ligji nr. 139/2015 - Per Vetëqeverisjen Vendore	54, 55	Miratim nga Këshilli Bashkiak; dorëzim tek Prefektura e Qarkut
Udhëzimi i MF nr. 7/2024	I gjithë	Format standard i pasqyrave financiare për njësitë e VQV
VKB nr. 87, dt. 19.12.2024	-	Miratimi i buxhetit fillestar 2025
VKB nr. 03, dt. 03.02.2025	-	Miratimi buxheti shtesë nga fondet e trashëguara
Ligji nr. 114/2015 Për Auditimin e Brendshëm	I gjithë	Kryerja e auditimeve të brendshme institucionale

1.5 Fjalori i Termave Financiare

Termi	Shpjegimi
Taksa vendore	Detyrime fiskale të bashkisë që paguhen sipas parashikimeve ligjore dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak.
Taksa të ndara	Taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë.
Tarifa vendore	Detyrime që individët ose bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi nga bashkia.
Transferta e pakushtëzuar	Fonde nga Qeveria Qendrore të dhëna pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi.
Transferta e kushtëzuar	Fonde nga Qeveria Qendrore për projekte të veçanta ose funksione të deleguara të bashkisë.
Transferta specifike	Fonde nga Qeveria Qendrore me kusht për t'u përdorur vetëm për funksione specifike të marra me ligj.
Trashëgimi nga viti i kaluar	Fonde buxhetore të pashpenzuara në mbyllje të vitit paraardhës, të përdorshme në vitin korrent.
Raport Vjetor i Konsoliduar	Raport i veprimtarisë financiare dhe zbatimit të buxhetit vjetor, i krahasueshëm me planin, sipas Nenet 50 Ligjit nr.68/2017.
ASHP	Agjencia e Shërbimeve Publike - njësia vartëse e Bashkisë Patos.
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm (3-vjeçar).

KREU II: QËLLIMI I BUXHETIT DHE REALIZIMI FINANCIAR - VITI 2025

2.1 Miratimi dhe Ndryshimet e Buxhetit 2025

Buxheti fillestar i vitit 2025 u miratua me VKB nr. 87, datë 19.12.2024, i konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier me shkresën nr. 1357/1 prot., datë 31.12.2024. Buxheti shtesë nga fondet e trashëguara u miratua me VKB nr. 03, datë 03.02.2025.

Qëllimet kryesore të buxhetit 2025: Zhvillimi Urban; Zhvillimi Social-Ekonomik; Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm; Zhvillimi i infrastrukturës dhe shërbimeve; Zhvillimi i sektorëve bujqësor dhe blegtoral.

Tabela 2.1 - Përbërja e Buxhetit 2025 (lekë)

Burimi i Buxhetit	Vlera (lekë)	Shënim
Buxheti fillestar (VKB nr. 87, 19.12.2024)	676,666,231	Transf. pakushtëzuar 228M + sektoriale 136M + të ardhura veta 312M
Fondet e trashëguara (VKB nr. 03, 03.02.2025)	278,819,548	Transf. pakushtëzuar 86M + sektoriale 49M + trashëgimi 143M
Shtesë transferata pakushtëzuar jashtë planit	5,041,886	Shpërndarë për shpenzime me buxhetin e trashëguar
Shtesë transferata sektoriale	1,302,000	Shpërbllim punonjës MZSH
Pakësime (mosrealizim të ardhurash)	(97,407,486)	Pakësim nga mosrealizimi burimeve vendore
Grant performancë	3,955,056	Fonde jashtë planit buxhetor
TOTAL PLAN I RISHIKUAR BUXHETI VENDOR 2025	868,377,235	Plani final i rishikuar

Ndryshimet me VKB gjatë Vitit 2025

VKB	Data	Objekti
VKB nr. 57	22.09.2025	Miratim projekti rrugësh "Heronjtë e Linasit", "Shpiragu" dhe "Sulo Goxhaj"
VKB nr. 58	22.09.2025	Transferim fondi nga Arsimi Bazë tek Furnizimi me Ujë - shtim rrjeti KUZ, Blloku Vreshiti
VKB nr. 62	22.09.2025	Miratim transferimit nxënësish shkolla "Sotir Çapo" Zharrëz
VKB nr. 60	22.09.2025	Ndryshim vendimi nr. 83/2024 - niveli i pagave bashkia dhe vartëset 2025
VKB nr. 63	15.10.2025	Ndryshim VKB nr. 87/2024 - buxheti 2025 me numrin përfundimtar punonjësve
VKB nr. 73	04.11.2025	Miratim ndihmës financiare për sëmundje të rëndë - zj. Liri Velmishi


2.2 Realizimi i Burimeve të Financimit

Realizimi faktik i burimeve të buxhetit vendor të Bashkisë Patos për periudhën janar–dhjetor 2025 arriti në **868,377,235 lekë** kundrejt planit të rishikuar **955,485,779 lekë**, duke realizuar **91%** të planit. Bashkë me fondet e kushtëzuara (365,056,953 lekë), realizimi total arriti **1,235,781,222 lekë**.

Tabela 2.2 - Burimet e Financimit 2023–2025 (000 lekë)

Kategoria	Burimi	Plan 2023	Plan 2024	Plan 2025	Fakt 2025	Realizimi %
Burimet e Veta	Taksa vendore	184,282	189,544	198,838	139,237	70%
	Taksa kombëtare (të ndara)	98,117	101,578	107,434	71,224	63%
	Tarifa vendore	2,300	3,010	3,010	2,428	81%
	Të ardhura të tjera	3,300	3,300	3,300	2,282	69%
	Donacion	0	1,226	0	0	-
SHUMA BURIMET E VETA		287,999	298,658	312,582	215,171	68%
Buxheti Qendror	Transf. pakushtëzuar	154,219	225,540	314,202	323,199	103%
	Transf. kushtëzuar	464,752	394,015	367,404	365,371	99%
	Transf. specifike	101,520	121,595	185,095	186,397	101%
SHUMA BUXHETI QENDROR		720,491	741,150	866,701	874,967	101%
Trashëgimi	Pa destinacion	217,310	179,848	143,605	143,605	100%
	Me destinacion	28,883	44,586	1	0	0%
SHUMA TRASHËGIMI		246,193	224,434	143,606	143,605	100%
TOTALI I BURIMEVE		1,254,683	1,264,242	1,322,889	1,233,743	93%

Grafiku 2.1 - Trend Burimeve të Financimit 2023–2025 (000 lekë)




Shënim: Grafiku i mëposhtëm paraqet trendin e burimeve kryesore të financimit për tre vitet 2023–2025. Vlerat e planit dhe faktit shprehen në mijë lekë.

Kategoria	Fakt 2023	Fakt 2024	Plan 2025	Fakt 2025	Ndryshimi 24→25
Burimet e Veta	287,999	298,658	312,582	215,171	-86,834 (-29%)
Buxheti Qendror	720,491	741,150	866,701	874,967	+133,817 (+18%)
Trashëgimi	246,193	224,434	143,606	143,605	-80,829 (-36%)
TOTALI	1,254,683	1,264,242	1,322,889	1,233,743	-33,846 (-3%)

Grafiku 2.2 - Struktura e Burimeve 2025 (pesha % sipas kategorisë)

Struktura Burimeve 2025



Kategoria	Vlera (000 lekë)	Pesha %	Interpretimi
Transferta pakushtëzuar	323,199	26%	Grant i zakonshëm qeveritar
Transferta kushtëzuar	365,371	30%	Fonde destinuar për shërbime specifike
Transferta specifike	186,397	15%	Funksione të deleguara
Të ardhura vendore (taksa+tarifa)	215,171	17%	Kapaciteti fiskal vetjak
Trashëgimi viti i kaluar	143,605	12%	Fonde të mbartura nga 2024
TOTALI	1,233,743	100%	Strukturë e qëndrueshme

Analiza Strukturore: Struktura e burimeve tregon varësi 71% nga transfertat qendrore - normale për bashki të vogla shqiptare. Burimet e veta (17%) shfaqin rënie prej 29% kundrejt vitit 2024, kryesisht nga: mospagesa taksës së truallit nga Albpetrol SHA (realizim 60%) dhe tarifës mjedisore nga Bankers Petroleum Albania LTD (realizim 84%) - në kuadër marrëveshjesh me këste aktive. Trashëgimia u realizua 100%, duke reflektuar angazhim efektiv të fondeve të mbartura.

2.3 Realizimi i të Ardhurave Vendore - Detajim i Plotë

Totali i arkëtuar janar–dhjetor 2025: **215,171,306 lekë** (realizim **68%** i planit 312,582,000 lekë). Ndarja sipas kategorisë: taksa të veta vendore 56,641,956 lekë; taksa kombëtare (të ndara) 71,223,640 lekë; të ardhura jo tatimore 87,306,324 lekë.

Tabela 2.3 - Të Ardhurat Vendore sipas Zërave (lekë)

Llogaria	Emërtimi	Plan 2025 (lekë)	Fakt 2025 (lekë)	Realizimi %
7020100	Taksë mbi tokën bujqësore	21,420,000	14,145,246	66%
7020200	Taksë mbi ndërtesat	22,050,000	16,304,492	74%
7020600	Taksë mbi truallin	38,500,000	22,956,935	60%

7035002	Taksë tregu	1,290,000	311,340	24%
7035003	Taksë ndikimi infrastrukturë	7,000,000	2,128,006	30%
7035009	Taksë tabelle	650,000	700,800	108%
7029200	Taksë kalim pronësie	400,000	95,138	24%
7204100	Taksë renta minerale	78,434,000	38,287,029	49%
7204102	Tatim mbi të ardhurat personale	10,000,000	13,586,304	102%
7204101	Taksë vjetore mjeteve	19,000,000	19,349,693	102%
	TË ARDHURA NGA TAKSAT	198,744,000	124,518,597	63%
7035049	Tarifa vaditje-kullim	2,880,000	949,036	33%
7110501	Tarifa pastrimi	42,031,000	33,699,311	80%
7190990	Tarifa shërbim komunitar	5,026,000	2,388,770	48%
7111007	Tarifa parkim	921,000	643,049	70%
7035035	Tarifa ndotje mjedisi	44,035,000	36,943,960	84%
7035013	Tarifa gjelbërimi	1,800,000	1,727,117	96%
7035023	Tarifa ndriçimi	1,800,000	1,718,217	95%
7110106	Tarifa leje/licensa/autorizim	4,179,000	873,240	21%
7035002	Tarifa hapësirave publike	250,000	507,010	203%
7035008	Tarifa reklame	507,000	0	0%
7111099	Tarifa shërbime të tjera adm.	1,899,000	1,010,620	53%
	TË ARDHURA NGA TARIFAT	107,578,000	82,596,158	77%
7109200	Qera tokë	1,300,000	581,276	45%
7109600	Qera ndërtesë	1,710,000	1,847,205	108%
	TË ARDHURA NGA QERA	3,010,000	2,428,481	81%
	Të ardhura kopeshite + çerdhe	2,800,000	2,248,551	80%
7115499	Gjoha	500,000	33,133	7%
	TË ARDHURA TË TJERA	3,300,000	2,281,684	69%
	TOTALI I TË ARDHURAVE VENDORE	312,582,000	215,171,306	68%

Shënime analitike: Taksa e ndërtesave +7% kundrejt 2024; taksa e tokës bujqësore +17% - rritje nga dixhitalizimi i regjistrimit dhe shpërndarja me postë faturave. Taksë truallit 60% - marrëveshje këstesh Albpetrol SHA aktive. Tarifa ndotje mjedisi 84% - marrëveshje këstesh Bankers Petroleum LTD aktive. Gjatë 2025 u regjistruan 40 subjekte të reja (490 total aktive: 108 Biznes i Madh + 382 Biznes i Vogël). Bllokimi llogarive bankare u zbatua dhjetor 2025 për debitorët.

2.4 Realizimi i Shpenzimeve Buxhetore

Shpenzimet buxhetore totale janar–dhjetor 2025: **726,853,746 lekë** kundrejt planit **956,737,779 lekë** - realizim **76%**. Bashkë me fondet e kushtëzuara (365,056,953 lekë): total realizim **1,091,910,699 lekë** kundrejt planit 1,228,479,780 lekë (89%).


Tabela 2.4 - Shpenzimet Buxhetore sipas Programeve 2023–2025 (000 lekë)

Nr.	Programi Buxhetor	Fakt 2023	Fakt 2024	Plan 2025	Fakt 2025	% 2025
1	Planifikimi, Menaxhimi, Administrimi	89,169	96,573	111,364	93,330	84%
2	Trashëgimia Kulturore dhe Artistike	15,000	23,572	17,383	16,431	95%

3	Sport dhe Argëtim	7,106	11,073	23,625	11,696	50%
4	Shërbime Bujqësore	6,790	5,804	10,857	9,343	86%
5	Mbrojtja e Mjedisit (Bashkia)	946	1,060	1,378	927	67%
6	Infrastruktura Rrugore (Bashkia)	125,866	122,435	242,649	153,111	63%
7	Strehimi Social	3,634	4,551	6,434	5,700	89%
8	Përkujdesi Social (Bashkia)	-	6,308	15,814	12,437	79%
8/1	Përkujdesi Social (ASHP)	-	-	9,913	8,992	91%
9	Furnizimi me Ujë	4,500	5,213	6,451	4,363	68%
10	Arsimi Bazë (Bashkia)	-	65,313	58,557	33,632	57%
10/1	Arsimi Bazë (ASHP)	121,048	78,369	89,152	74,347	83%
11	Arsimi i Mesëm (ASHP)	4,920	8,302	9,985	5,791	58%
12	Mbrojtja nga Zjarri dhe Emergjencat	28,131	28,740	30,368	25,615	84%
13	Ujitja dhe Kullimi (Bashkia + ASHP)	39,543	41,292	45,936	39,525	86%
14	Pyjet dhe Kullotat (ASHP)	2,350	3,102	3,515	2,090	59%
15	Rrjeti Rrugor Rural (ASHP)	18,940	20,111	23,957	22,543	94%
16	Shërbime Publike Vendore (ASHP)	162,534	171,812	181,438	151,106	83%
17	Menaxhimi Mbetjeve Urbane (ASHP)	53,285	58,919	64,310	55,676	87%
18	Fondi Rezervë	200	580	1,046	200	19%
19	Fondi Kontigjencë	0	0	2,606	0	0%
	TOTAL	705,010	756,339	956,737	726,854	76%


Grafiku 2.3 - Shpenzimet sipas Kategorisë Ekonomike 2025

Struktura Burimeve 2025



Kategoria Ekonomike	Plan 2025 (lekë)	Fakt 2025 (lekë)	Realizimi %	Pesha % e totalit
Pagat dhe sigurime (600+601)	360,326,625	333,296,537	93%	46%
Mallra dhe shërbime (602-609)	177,647,222	125,016,981	70%	17%
Investime kapitale (231)	418,763,932	268,540,228	64%	37%
TOTALI	956,737,779	726,853,746	76%	100%

Grafiku 2.4 - Trend Shpenzimeve 2023–2025 (000 lekë)



Viti	Plan (000 lekë)	Fakt (000 lekë)	Realizimi %	Ndryshim kundrejt vitit paraardhës
2023	-	705,010	-	-
2024	-	756,339	-	+51,329 (+7.3%)
2025	956,737	726,854	76%	-29,485 (-3.9%)

2.5 Investimet Kapitale 2025 - Tabela e Detajuar

Plan investimesh: 418,763,932 lekë (44% e buxhetit total). **Realizuar:** 268,540,228 lekë (64% e planit).
Nota: Kontrata të lidhura dhe projekte në proces zbatimi/prokurimi.

Tabela 2.5 - Investimet Kapitale sipas Projekteve 2025 (000 lekë)

Kodi	Emërtimi i Projektit	Buxheti 2025	Financuar 2024	Realizimi 2025	Progresiv	Statusi
01110	Pajisje zyre + informatike	1,952	0	1,452	1,452	Përfunduar
03280	Mur mbajtës - rruga Ymeraj	2,422	0	2,230	2,230	Përfunduar
04240	Ujitje-kullim, skema të reja + kolaudues	16,209	0	15,317	15,317	Përfunduar
04240	Ministacione vaditje Zharrëz	10,765	0	10,057	10,057	Përfunduar
04520	Rikonstruksion bllok - Pallati i Kulturës	47,338	0	47,338	47,338	Përfunduar
04520	Rikonstruksion blloku Vreshti - Lagjja e Re	42,952	0	42,888	42,888	Përfunduar
04520	Mure mbajtëse - qytet dhe rrethinë	2,154	5,392	2,064	7,457	Përfunduar
04520	Rruga Industriale - kryq. Frans Nopce	8,568	0	8,538	8,538	Përfunduar
04520	Rruga Unazë - Varreza - Dhori Tanaka	13,335	0	11,660	11,660	Përfunduar
04520	Rehabilitim lulishte - stadiumi	2,660	10,083	2,660	12,743	Përfunduar

04520	Sinjalistikë rrugore	1,485	0	1,485	1,485	Përfunduar
04520	Bazë materiale - varreza publike	5,000	0	4,810	4,810	Përfunduar
04520	Sistemim hapësirë pas bllokut ish-bashkisë	1,344	0	0	9,415	Në proces
04520	Blerje mjet autobetoniere	5,000	0	0	0	Në proces
04520	Rikonstruksion blloke banimit - Lagjja 1 Maj	16,904	0	0	0	Në proces
04520	Rruga Ali Laze + Qerim Gropa	20,000	0	57	57	Në proces
04520	Rruga Kripallarët	22,383	0	0	0	Proces prokurimi
04520	Rruga Frashër-Fshat i Ri Zharrëz	205	0	145	145	Në proces
04520	Rrugë Heronjtë Linasit + Shpiragu + Sulo Goxhaj	7,700	0	0	0	Në proces
04520	Rruga Lagjja e Re - Perroi Cam	7,734	16,713	0	16,713	Në proces
04520	Hartim PDV + studim-projektim projekte	6,807	0	6,607	6,607	Në proces
06370	Ndërtim KUZ dhe KUB (bazë materiale)	6,451	0	4,363	4,363	Përfunduar
08130	Ndërtim fusha basketbolli - Patos	10,574	0	0	0	Proces prokurimi
09120	Rikonstruksion shkolla Muhamet Shehu + Palestër	843	0	843	843	Përfunduar
09120	Rikonstruksion kopeshti me drekë Patos	37,727	0	28,370	28,370	Në proces
09120	Rikonstruksion kopeshti Verbas - Q. Ambulatore	3,368	0	3,203	3,203	Përfunduar
09120	Rikonstruksion shkolla Sotir Çapo Zharrëz+Palestër	5,800	0	0	0	Në proces
09120	Mobilim + pajisje kopeshti me drekë	8,000	0	0	0	Proces prokurimi
05100	Kontejnerë 3 njësi (ASHP)	6,656	0	6,615	6,615	Përfunduar
05100	Makina pastrimi mbetjesh (ASHP)	4,818	0	4,818	4,818	Përfunduar
06260	Asfalto-Beton shtrim rrugësh (ASHP)	56,334	0	38,956	38,956	Likujdim
06260	Ndriçim rrugor - bazë materiale (ASHP)	9,903	0	9,902	9,902	Përfunduar
06260	Mjet shërbimi administratë (ASHP)	3,000	0	2,976	2,976	Përfunduar
06260	Fuoristrade 4x4 (ASHP)	2,000	0	1,996	1,996	Përfunduar
06260	Kamioncine (ASHP)	3,000	0	2,996	2,996	Përfunduar
06260	Stola lulishte qyteti (ASHP)	2,500	0	2,325	2,325	Përfunduar
06260	Ndërtim trotuare dhe sheshe pallatesh (ASHP)	5,500	0	468	468	Përfunduar
10661	Përmirësim banesash - komunitete të varfra	836	0	800	800	Në proces
04520	Mbikqyrës + kolaudues (diverse)	607	0	346	346	Në proces
	TOTAL BUXHETI VENDOR	418,764	32,188	268,540	310,144	64% realizim

2.6 Fondet e Kushtëzuara - Realizimi 2025

Plan: 367,403,987 lekë. **Realizuar:** 365,056,953 lekë (99%). Fonde nga ministrinë qendrore për funksione të deleguara.

Tabela 2.6 - Fondet e Kushtëzuara sipas Ministrive (lekë)

Programi	Burimi (Ministria)	Plan (lekë)	Fakt (lekë)	Realizimi %
Gjendja Civile (1170)	Min. Brendshme	7,705,343	7,529,410	98%
Invalidët / PAAK (10430)	Min. Shëndetësisë+Sociale	174,289,690	172,872,419	99%
Ndihma Ekonomike (10430)	Min. Shëndetësisë+Sociale	16,119,886	15,546,479	96%
PAAK / Gjqësor (10430)	Min. Shëndetësisë+Sociale	29,658,075	29,658,075	100%
Perkrahja Sociale (10430)	Min. Shëndetësisë+Sociale	2,519,280	2,459,997	98%
Arsimi Bazë + Muhamet Shehu	Min. Arsimit	17,043,490	17,010,545	100%
Arsimi Mesëm - Sotir Çapo	Min. Arsimit	32,752,887	32,752,800	100%
Strehimi Social (6190)	Min. Infrastrukturës	4,772,987	4,772,987	100%
Magistral Ujësjetllës (6370)	Min. Infrastrukturës	50,946,480	50,946,480	100%
Emergjencat Civile (10910)	Min. Financave	29,666,039	29,622,730	100%
KZAZ (1620)	Min. Brendshme	1,929,830	1,885,031	98%
TOTAL FONDET E KUSHTËZUARA		367,403,987	365,056,953	99%

2.7 Treguesit Financiarë Kyç - Viti 2025

Tabela 2.7 - 12 Treguesit Financiarë Ligjorë

Nr.	Treguesi Financiar	Numëratori (000 lekë)	Emëruesi (000 lekë)	Raporti	Interpretimi
1	Shpenzime / të ardhura totale	726,854	956,738	76%	Buxhet nën plan - normal
2	Të ardhura veta / total buxheti	355,434	956,738	37%	Varësi mesme nga buxheti qendror
3	Taksë+tarifë faktike / plan	31,561	312,582	10%	Mosrealizim - prioritet arkëtimi
4	Investime kapitale / shpenzime totale	268,540	726,854	37%	Proporcion i mirë investimesh
5	Shpenzime personeli / totale	333,297	726,854	46%	Brenda normave ligjore
6	Huamarrje afatgjatë / të ardhura totale	0	956,738	0%	Pa hua - tregues pozitiv
7	Huamarrje afatgjatë / të ardhura veta	0	355,434	0%	Pa hua - tregues pozitiv
8	Huamarrje afatshkurtër / të ardhura totale	0	956,738	0%	Pa hua - tregues pozitiv
9	Detyrime tatimore të pashlyera	0	312,582	0%	Nuk ka detyrime të prapambetura
10	Partneritet publik-privat / totale	0	726,854	0%	Nuk ka PPP të raportuara
11	Shpenzime kujdes shoqëror / totale	7,461	726,854	1%	Brenda normave të planit
12	Shpenzime barazi gjinore / totale	4,081	726,854	0.56%	Mbështetje minimale sektoriale

KREU III: ANALIZA E DETAJUAR E PROGRAMEVE BUXHETORE - PJESA A

Kreu III paraqet analizën e detajuar për secilën program buxhetor të Bashkisë Patos dhe njësisë vartëse ASHP për periudhën janar–dhjetor 2025. Për çdo program jepen: përshkrimi, qëllimi, shpenzimet sipas zërave ekonomikë, produktet dhe treguesit e performancës, vlerësimi cilësor i arritjeve dhe sfidave.

III.1 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi

Kodi: 01110 | Njësia Shpenzuese: Bashkia Patos

Pershkrimi i Programit

Programi 01110 mbulon funksionimin e administratës qendrore të Bashkisë Patos dhe siguron shërbime mbështetëse për të gjitha programet e tjera buxhetore. Ai përfshin:


- (i) Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të përgjithshme për personelin dhe burimet njerëzore;
- (ii) Shërbime të përgjithshme publike: prokurimi, arkivat, administrimi ndërtesave, parqet e automjeteve, zyrat e printimit dhe sistemet IT;
- (iii) Mbështetja e Kryetarit të Bashkisë, Këshillit Bashkiak dhe komisioneve;
- (iv) Shërbimet statistikore dhe baza e të dhënave vendore;
- (v) Informacioni publik, transparenca dhe dokumentacioni teknik;
- (vi) Policia Bashkiake dhe mbikëqyrja e Inspektoratit IVMT.

Qellimi dhe Objektivat e Politikës

Qeverisje vendore e përgjegjshme, efiçente dhe transparente. Pushteti vendor bashkëpunues si nxitës i zhvillimit ekonomik lokal, me përdorim optimal të burimeve financiare dhe njerëzore. Promovim aktiv i qeverisjes së hapur dhe të aksesueshme për çdo qytetar.

Grafiku III.1.1 - Trend Shpenzimeve 2023–2025 (000 leke)

Struktura — III.1_Adm




Viti	Plan (000 lekë)	Fakt (000 lekë)	Realizimi %	Ndryshimi vs viti paraardhës
2023	89,169	89,169	-	-
2024	96,573	96,573	-	+7,404 (+8.3%)
2025	111,364	93,330	84%	-3,243 (-3.4%)

Tabela III.1.1 - Shpenzimet sipas Klasifikimit Ekonomik (000 leke)

Kategoria Ekonomike	Plan 2025	Fakt 2025	Realizimi %
Pagat (600)	66,676	62,036	93%
Sigurimet Shoqërore (601)	12,124	10,410	86%
Mallra dhe shërbime (602)	28,896	18,615	64%
Transf. korrente brendshme (604)	0	0	-
Transf. familjare / individë (606)	1,717	817	48%
Kapitale trupëzuara (231)	1,952	1,452	74%
TOTALI	111,364	93,330	84%

Grafiku III.1.2 - Struktura e Shpenzimeve 2025 (pesha %)



Kategoria	Fakt 2025 (000 leke)	Pesha %
Pagat	62,036	66.5%
Sigurimet Shoqërore	10,410	11.2%
Mallra dhe shërbime	18,615	19.9%
Transf. korrente brendshme	0	0.0%
Transf. familjare / individë	817	0.9%
Kapitale trupëzuara	1,452	1.6%

Tabela III.1.2 - Produktet dhe Kostot (000 leke)

Produkti	Njesia	Plan	Fakt	Shpz Plan	Shpz Fakt
Shërbimi i Stafit (Adm+Menaxhim)	numër	69	56	80,517	73,263
Akte të miratuara nga KB	numër	90	85	10,023	8,575
Infrastruktura dhe funksionimi i aparatit	numër	12	12	15,646	9,023
Detyrime gjyqësore të përmbushura	numër	5	3	2,077	644
Nëpunës të trajnuar	numër	85	72	950	225
Transparencë publike (pjesëmarrës dëgjesa)	numër	1,200	1,200	200	148

Tabela III.1.3 - Treguesit e Performances (Plan vs Fakt 2025)

Treguesi	Njesia Matese	Plan 2025	Fakt 2025	Realizimi %
Procedura prokurimi vlera të mëdha	numër	20	19	95%
Procedura prokurimi blerje të vogla	numër	46	22	48%
Konsultime publike	numër	22	20	91%
Punonjës policia bashkiake	numër	5	5	100%
Patrullime siguri publike	numër	105	103	98%
Procesverbal konstatimi IVMT	numër	30	21	70%
Procesverbal pezullimi punimesh IVMT	numër	15	2	13%
Gjoha IVMT	numër	5	3	60%
Shërbime administrative për qytetarë	numër	72	69	96%
Qytetarë me shërbim (mesatare / muaj)	numër	600	600	100%
Takime pritje me titullarin (mesatare / muaj)	numër	100	97	97%
Vërtetime banor për brenda / jashtë vendit	numër	300	296	99%
Trajnim punonjës administratë (%)	%	100%	89%	89%
Rrotullim stafi (qëndrueshmëri)	%	20%	5.1%	-
Bashkia mbyllur bilancin pa deficit	Po/Jo	Po	Po	100%

Tabela III.1.4 - Projektet e Investimeve Kapitale (000 leke)

Kodi	Emertimi i Projektit	Vlera Totale	Buxheti 2025	Fakt 2025	Statusi
01110	Pajisje zyre + informatike	1,952	1,952	1,452	Përfunduar

Vleresim Cilesore - Arritjet dhe Sfidat e Programit III.1**ARRITJET:**

1. Bashkia e mbyll vitin buxhetor pa deficit - stabilitet financiar i konfirmuar me sufiçit 141,519,464 lekë.
2. Transparencë publike 100%: 1,200 pjesëmarrës në dëgjesa publike dhe 20 konsultime publike (plan 22).
3. Qëndrueshmëri administrative shumë e lartë: rrotullimi i stafit vetëm 5.1% kundrejt 20% të planifikuar.
4. 19 nga 20 procedura prokurimi me vlera të mëdha të realizuara (95%). Të gjitha 12 procedurat mirëmbajtjes infrastrukturës të kryera.
5. Policia Bashkiake aktive: 5 punonjës, 103 patrullime (plan 105), 97% realizim takimesh me qytetarë.

6. Shërbime administrative 69 nga 72 (96%) dhe 600 qytetarë/muaj sipas planit.

SFIDAT DHE REKOMANDIMET:

1. Blerjet e vogla nëpërmjet prokurimit: 22 nga 46 planifikuara (48%) - boshllëk i rëndësishëm operacional.
2. Mallra dhe shërbime realizuan 64% (18,615 vs 28,896 mijë lekë) - vonesë zbatimi kontratave.
3. Trajnim punonjës 89% kundrejt 100% planifikuar - 13 nëpunës pa trajnim gjatë vitit.
4. Procesverbale IVMT: pezullim punimesh vetëm 2 nga 15 planifikuara (13%) - kapacitet i ulët inspektimi.
5. Transfertat familjare 48% (817 vs 1,717 mijë lekë) - nën pritshmëri.
6. Rekomandim: fillim i ciklit prokurimit blerje të vogla në janarin e vitit të ardhshëm.

III.2 - Fondi Rezervë

Kodi: 04910 | Njësia Shpenzuese: Bashkia Patos

Persh krimi i Programit

Fondi Rezervë është instrument ligjor i bashkisë i cili aktivizohet ekskluzivisht me Vendim të Këshillit Bashkiak. Ai përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve që nuk njihen ose janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit.

Bazë ligjore: Neni 65 i Ligjit nr. 68/2017 dhe Neni 9 i Ligjit nr. 9936/2008 'Për menaxhimin e sistemit buxhetor'. Vlera planifikuar: 1,046,000 lekë. Vlera e aktivizuar: 200,000 lekë (transferte familjare për rast emergjent).


Fondi Rezervë NUK duhet ngatërruar me Fondin Kontigjencë (04940): Rezerva është për shpenzime të paparashikuara; Kontigjenca është për efektet e mosrealizimit të ardhurave.

Qellimi dhe Objektivat e Politikës

Sigurimi i mbulimit financiar për nevoja emergjente dhe të paparashikuara gjatë zbatimit të buxhetit vendor, duke garantuar vazhdimësinë e shërbimeve publike pa penguar ekuilibrin buxhetor.

Grafiku III.2.1 - Trend Shpenzimeve 2023–2025 (000 leke)

Struktura — III.2_Rezerve




Viti	Plan (000 lekë)	Fakt (000 lekë)	Realizimi %	Ndryshimi vs viti paraardhës
2023	200	200	-	-
2024	580	580	-	+380 (+190.0%)
2025	1,046	200	19%	-380 (-65.5%)

Tabela III.2.1 - Shpenzimet sipas Klasifikimit Ekonomik (000 leke)

Kategoria Ekonomike	Plan 2025	Fakt 2025	Realizimi %
Transf. familjare / individë (606)	200	200	100%
Fond rezervë i planifikuar (606)	846	0	0%
TOTALI	1,046	200	19%

Grafiku III.2.2 - Struktura e Shpenzimeve 2025 (pesha %)



Ë Lidhur me Excel. Ndryshimet ne Excel reflektohen ketu me F9 ose rihapjes te dokumentit.

Kategoria	Fakt 2025 (000 leke)	Pesha %
Transf. familjare / individë	200	100.0%
Fond rezervë i planifikuar	0	0.0%

Tabela III.2.2 - Produktet dhe Kostot (000 leke)

Produkti	Njesia	Plan	Fakt	Shpz Plan	Shpz Fakt
Fondi Rezervë (aktivizim rast emergjent)	numër	1	1	1,046	200

Tabela III.2.3 - Treguesit e Performances (Plan vs Fakt 2025)

Treguesi	Njesia Matese	Plan 2025	Fakt 2025	Realizimi %
VKB-të për aktivizim fondi	numër	-	1	-
Vlera e aktivizuar (000 lekë)	000 lekë	1,046	200	19%
Raste emergjente të financuara	numër	-	1	-

Vleresim Cilesore - Arritjet dhe Sfidat e Programit III.2

ARRITJET:

- Aktivizim i kontrollorur dhe i justifikuar ligjërisht - vetëm 1 rast i vërtetë emergjent gjatë 2025.
- Mosshpenzimi i shumicës (846,000 lekë) tregon parashikim të mirë të shpenzimeve gjatë vitit.
- Nuk pati nevoja emergjente të mëdha - tregues i stabilitetit operacional të bashkisë.
- Transferta familjare e aktivizuar (200,000 lekë) u realizua 100%.

SFIDAT DHE REKOMANDIMET:

- Realizimi 19% (200 vs 1,046 mijë lekë) tregon mbi-planifikim: vlera mesatare historike 2023-2025 është ~327 mijë lekë/vit.
- Plan 2026: rekomandohet ulje e planit në ~400,000 lekë bazuar mbi historikun 3-vjeçar.
- Metodologjia e planifikimit të fondit rezervë duhet rishikuar çdo vit para hartimit të buxhetit.

III.3 - Fondi Kontigjencë

Kodi: 04940 | Njësia Shpenzuese: Bashkia Patos

Persh krimi i Programit

Fondi i Kontingjencës është instrument buxhetor i parashikuar nga Ligji nr. 68/2017 (Neni 66) për të përballuar:


- (i) Efektet e mosrealizimit të të ardhurave - nëse të ardhurat faktike bien ndjeshëm nën planin vjetor;
- (ii) Nevojën e kryerjes së financimeve të reja të paparashikuara gjatë vitit;
- (iii) Shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara të programeve ekzistuese.

Aktivizimi bëhet ekskluzivisht me VKB dhe vetëm në rast nevoje dokumentuar. Programi u krijua si program i veçantë buxhetor për herë të parë në vitin 2025 - në vitet 2023 dhe 2024 nuk kishte vlerë të planifikuar.

Qellimi dhe Objektivat e Politikës

Menaxhimi i rreziqeve buxhetore. Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare vendore në rast gjendjesh të paparashikuara që kërcënojnë vazhdimësinë e shërbimeve publike bazë.

Grafiku III.3.1 - Trend Shpenzimeve 2023–2025 (000 leke)




Viti	Plan (000 lekë)	Fakt (000 lekë)	Realizimi %	Ndryshimi vs viti paraardhës
2023	0	0	-	-
2024	0	0	-	-
2025	2,606	0	0%	-

Tabela III.3.1 - Shpenzimet sipas Klasifikimit Ekonomik (000 leke)

Kategoria Ekonomike	Plan 2025	Fakt 2025	Realizimi %
Transf. familjare / individë (606)	2,606	0	0%
TOTALI	2,606	0	0%

Grafiku III.3.2 - Struktura e Shpenzimeve 2025 (pesha %)



∪ Lidhur me Excel. Ndryshimet ne Excel reflektohen ketu me F9 ose rihapjes te dokumentit.

Kategoria	Fakt 2025 (000 leke)	Pesha %
Transf. familjare / individë	0	0.0%

Tabela III.3.2 - Produktet dhe Kostot (000 leke)

Produkti	Njesia	Plan	Fakt	Shpz Plan	Shpz Fakt
Fondi Kontigjencë (i paaktivizuar)	numër	1	0	2,606	0

Tabela III.3.3 - Treguesit e Performances (Plan vs Fakt 2025)

Treguesi	Njesia Matese	Plan 2025	Fakt 2025	Realizimi %
Aktivizime gjatë vitit 2025	numër	-	0	0%
VKB-të për aktivizim	numër	-	0	-
Vlera e aktivizuar (000 lekë)	000 lekë	2,606	0	0%

Vleresim Cilesore - Arritjet dhe Sfidat e Programit III.3

ARRITJET:

- Mosshpenzimi i plotë reflekton stabilitet buxhetor dhe mungesë gjendjesh emergjente të paparashikuara gjatë 2025.
- Bashkia arriti të menaxhojë nevojat e rishpërndarjes buxhetore nëpërmjet VKB-ve të transferimit ndërmjet programeve pa aktivizuar fondin.
- Asnjë deficit i paparashikuar i ardhurave nuk kërkoi aktivizimin - tregues pozitiv i arkëtimit të rregullt.

SFIDAT DHE REKOMANDIMET:

- Realizim 0% tregon planifikim jo realist: fondi u krijua por nuk u nevojiti.
- Rekomandohet transferimi i 2,606,000 lekëve të papërdorura tek programet me performancë të ulët: Pyjet 04260 (59%), Arsimi Mesëm 09230 (58%), Mbrojtja Mjedisit 05100 (67%).
- Plan 2026: vlerë minimale simbolike (~500,000 lekë) ose bashkim me Fondin Rezervë.

III.4 - Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore

Kodi: 08220 | Njësia Shpenzuese: ASHP (Agjencia e Shërbimeve Publike)

Pershkrimi i Programit

Programi 08220 mbulon funksionin kulturor të Bashkisë Patos nëpërmes Agjencisë së Shërbimeve Publike (ASHP) si njësi shpenzuese. Përfshin:


- (i) Zhvillim, mbrojtje dhe promovim i vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor;
- (ii) Administrim i objekteve kulturore: Qendra Kulturore e Fëmijëve, Muzeu, Biblioteka Publike, Pallati i Kulturës;
- (iii) Mbeshtetje vendeve historike: Beteja e Margellicit, monumentet partizane;
- (iv) Organizim i ngjarjeve kulturore: koncerte, prodhime skenike, shfaqje artistike, aktivitete për breza të ndryshëm;
- (v) Promovim identiteti kombëtar e lokal - ceremonitë zyrtare historike;
- (vi) Shtim i koleksionit të Bibliotekës Publike me tituj të rinj.

Qellimi dhe Objektivat e Politikës

Plotesimi i infrastrukturës së objekteve social-kulturore për zhvillim cilësor dhe organizim veprimtarish artistike-kulturore-sociale me gjithëpërfshirje në të gjithë territorin e Bashkisë Patos. Promovim dhe ruajtje trashëgimie kulturore. Rritje ndërgjegjësimi dhe përfshirje komuniteti në jetën kulturore.

Grafiku III.4.1 - Trend Shpenzimeve 2023–2025 (000 lekë)

Struktura — III.4_Kulture




Viti	Plan (000 lekë)	Fakt (000 lekë)	Realizimi %	Ndryshimi vs viti paraardhës
2023	15,000	15,000	-	-
2024	23,572	23,572	-	+8,572 (+57.1%)
2025	17,383	16,431	95%	-7,141 (-30.3%)

Tabela III.4.1 - Shpenzimet sipas Klasifikimit Ekonomik (000 leke)

Kategoria Ekonomike	Plan 2025	Fakt 2025	Realizimi %
Pagat (600)	11,264	11,214	100%
Sigurimet Shoqerore (601)	1,834	1,284	70%
Mallra dhe sherbime (602)	3,925	3,797	97%
Transf. familjare / individe (606)	360	136	38%
Kapitale (231)	0	0	-
TOTALI	17,383	16,431	95%

Grafiku III.4.2 - Struktura e Shpenzimeve 2025 (pesha %)



Kategoria	Fakt 2025 (000 leke)	Pesha %
Pagat	11,214	68.2%
Sigurimet Shoqerore	1,284	7.8%
Mallra dhe sherbime	3,797	23.1%
Transf. familjare / individe	136	0.8%
Kapitale	0	0.0%

Tabela III.4.2 - Produktet dhe Kostot (000 leke)

Produkti	Njesia	Plan	Fakt	Shpz Plan	Shpz Fakt
Staf trashegimia kulturore / muzeu / biblioteke	numer	24	8	13,458	12,634
Objekte kulturore te mirembajtura dhe funksionale	numer	4	4	175	99
Promovim trashegimie kulturore (aktivitete)	numer	12	12	3,750	3,698

Tabela III.4.3 - Treguesit e Performances (Plan vs Fakt 2025)

Treguesi	Njesia Matese	Plan 2025	Fakt 2025	Realizimi %
Shfaqje kulturore + evente artistike	numer	5	5	100%
Aktivite artistike brezin e ri	numer	5	5	100%
Aktivite sportive	numer	3	3	100%
Ceremoni zyrtare historike	numer	4	4	100%
Libra te rinj ne biblioteke	numer	120	140	117%
Objekte kulturore ne funksion	numer	4	4	100%

Lista e Aktiviteve Kulturore te Realizuara 2025

Nr.	Aktiviteti
1	1. Aktivite ne Biblioteke gjate gjithë vitit
2	2. Ceremoni perkujtimore e Aksionit te Patosit
3	3. Shfaqja e komedise 'Pallati 176' per festat e 7 Marsit
4	4. Ceremonia zyrtare e 81-vjetorit te Betejes se Margellicit
5	5. Aktivitet me veteranet per Margellicin
6	6. Aktivitet per Diten e Verses
7	7. Ceremonia zyrtare e Dites se Deshmort
8	8. Kampionate sportive nga QKF
9	9. Promovimi i librit te autorit Luftar Kuka
10	10. Aktivitet per festat e 1 Qershorit (Dita e Femijeve)
11	11. Aktivite artistike-kulturore per festat e qytetit
12	12. Koncert festiv 'Patosi-fest'
13	13. Festa lokale NJA Zharrez: 'Brez pas brezi myzeqar'
14	14. Aktivitet per Diten e te Moshuarve
15	15. Festa lokale NJA Ruzhdie: 'Sofra bujare'
16	16. Ceremoni perkujtimore batalioni partizan 'Petro Sota' - Sheqishte
17	17. Koncerti festiv me shkollat per festat e Nentorit
18	18. Koncerte per ngjarjet historike nga QKF
19	19. 'Kupa e Clirimit' ne futboll me shkollat 9-vjecare
20	20. Ceremonia zyrtare e 81-vjetorit te Clirimit dhe 113-vjetorit te Pavarecise
21	21. Aktivitet me veteranet per festat e Clirimit
22	22. Ndezja e dritetave te pemes se Krishtlindjeve dhe Vitit te Ri
23	23. Dita e Rinise - aktivitet me nxenesit e dalluar
24	24. Koncert festiv per Krishtlindje dhe Vit te Ri 2026
25	25. Ndarje paketash dhurata per nxenesit e dalluar dhe femije me AN
26	26. Pasurimi i bibliotekes me libra artistike

Vleresim Cilesore - Arritjet dhe Sfidat e Programit III.4

ARRITJET:

1. Realizim i larte 95% - program me menaxhim eficient dhe shpenzime te kontrolluara.
2. 26 aktivitete kulturore te realizuara gjate vitit 2025 - me sipas planit fillestar.
3. Te gjitha 4 ceremonite zyrtare historike realizuara ploterisht (81-vjetori Margellicit, 81-vjetori Clirimit, 113-vjetori Pavarecise, Deshmort).
4. Biblioteka pasuruar me 140 libra te rinj - 117% e planit prej 120 librash.
5. Te gjitha 4 objekte kulturore funksionale (QKF, Muzeu, Biblioteka, Pallati Kultures).
6. Pagat 100% te realizuara - staf plotesisht aktiv.
7. Promovim 12 aktivitetesh kulturore ne plan dhe fakt (100%).

SFIDAT DHE REKOMANDIMET:

1. Staf kulturor: vetem 8 nga 24 punonjes sipas planit (33%) - boshllëk serioz organizativ.
2. Transfertat per individe (subvencione artistike): 38% (136 vs 360 mije leke) - artistet vendas pa mbeshtetje financiare te planifikuar.
3. Sigurimet Shoqerore: 70% - problem kontributiv qe duhet adresuar me DRT.
4. Rekomandohet rritja e planit transfertave per artistet vendas ne buxhetin 2026.
5. Rishikim i structures organike te sektorit kulturor me fokus plotesim vendesh vakante.

III.5 - Sport dhe Argetim

Kodi: 08130 | Njësia Shpenzuese: Bashkia Patos + ASHP (konsoliduar)

Pershkrimi i Programit

Programi 08130 konsolidon dy njësi shpenzuese me detyra të ndryshme por qëllim të përbashkët: promovimi i sportit dhe argerimit për qytetaret e Bashkisë Patos.

BASHKIA PATOS - investim kapital (10,574 mijë leke): ndërtim i fushave të basketbollit për njësitë Patos - projekt i planifikuar që mbeti në proces prokurimi gjatë 2025.

ASHP - shpenzime korrente (13,051 mijë leke): administrim ekuipave sportive (futboll, boks, volejbol), staf trajnerësh dhe mbështetje për klubin lokal të futbollit.

Rritja e madhe e planit 2025 (+113% nga 2024) vjen kryesisht nga investimi kapital i fushave të basketbollit që u fut për herë të parë në buxhet.


Rezultate sportive 2025: Klubi futbollit: 20 lojtare të rritur + 71 të vegjël; 16 ndeshje të rritur + 40 të vegjël. Boksi: 44 sportiste. Volejboli femra: 12 sportiste.

Qëllimi dhe Objektivat e Politikës

Rritja e aksesit dhe cilësive të strukturave sportive dhe rekreacionale për të gjithë qytetaret, pa dallim mosha apo aftësi. Promovim i jetës aktive dhe të shëndetshme. Mbështetje ekuipave sportive vendore dhe aktiviteteve rekreacionale që përforcojnë bashkësinë lokale.

Grafiku III.5.1 - Trend Shpenzimeve 2023–2025 (000 lekë)

Struktura — III.5_Sport




Viti	Plan (000 lekë)	Fakt (000 lekë)	Realizimi %	Ndryshimi vs viti paraardhës
2023	7,106	7,106	-	-
2024	11,073	11,073	-	+3,967 (+55.8%)
2025	23,625	11,696	50%	+623 (+5.6%)

Tabela III.5.1 - Shpenzimet sipas Klasifikimit Ekonomik (000 leke)

Kategoria Ekonomike	Plan 2025	Fakt 2025	Realizimi %
ASHP - Pagat (600)	4,427	4,426	100%
ASHP - Sigurimet Shoqerore (601)	756	744	98%
ASHP - Mallra dhe sherbime (602)	7,796	6,511	83%
ASHP - Transf. familjare / individe (606)	72	15	21%
ASHP - TOTALI KORRENTE	13,051	11,696	90%
BASHKIA - Kapitale (231) fusha basketbolli	10,574	0	0%
TOTALI KONSOLIDUAR	23,625	11,696	50%

Grafiku III.5.2 - Struktura e Shpenzimeve 2025 (pesha %)



Kategoria	Fakt 2025 (000 leke)	Pesha %
ASHP - Pagat	4,426	37.8%
ASHP - Sigurimet Shoqerore	744	6.4%
ASHP - Mallra dhe sherbime	6,511	55.7%
ASHP - Transf. familjare / individe	15	0.1%
BASHKIA - Kapitale	0	0.0%

Tabela III.5.2 - Produktet dhe Kostot (000 leke)

